

Një Mbrëmje E Bukur Me Sportistët Shqiptarë Në Boston

Nga Fuat Memeli

Dy orë e ca zgjati takimi i bukur kushtuar sportistëve të shquar shqiptarë që jetojnë në Boston e qytetet e tjere rreth tij. Ishin orë që kaluan pa u ndier. I shkurtorj minutat e takimit, jeta e bukur sportive e atyre që i kushtohej kjo veprimtari. E bëri atë që të mos ndihej, edhe drejtimi me kulturë, elegancë e humor nga komentatori i shquar sportiv dhe shkrimtari, Skifter Këlliçi.



Agron Alibali duke treguar nje kalendar te "Vatres"

restoranti "Pier 4", ndërtuar shumë vite më parë nga biznesmeni i shquar shqiptar, i ndjeri Antoni Athanas, e që sot administrohet nga djemtë e tij. Një njoftim i Shoqatës "Massalbania" Besa", e cila është zemra e shqiptarëve të në shtetin e Masaçusetes, mjaftoi për të mbledhur dhjetra shqiptarë, jo vetëm sportistët e shquar të cilëve u kushtohej veprimtaria por edhe dashamirës të tjere të sportit, miq e të afërm të tyre, shqiptarë e amerikanë.-Sot jemi mbledhur për të nderuar sportistët e shquar shqiptarë që jetojnë në Boston e qytetet e tjere rreth tij, theksoi në fillim të fjalës së tij, Agron Alibali , një nga organizatorët kryesorë të këtij takimi. Pastaj ai paraqiti një kalendar të "Vatres" ku ndër të tjera ishte paraqitur ekipi shqiptar i bejzbollit në Boston, në vitin 1918. Kjo foto e rrallë, kaloi dorë më dorë tek të pranishmit. Një informacion për sportistët e vjetër shqiptarë në Amerikë që i përkasin shekullit të kaluar , paraqiti shqiptaro-amerikani , Van Kristo. Pastaj hyn në " lojë" ish komentatori i shquar sportiv i Radio Televizionit Shqiptar dhe shkrimtari , Skiftër Këlliçi. Ai fton së pari pranë mikrofonit, ish basketbollistin e shquar të ekipit të "17 Nëntorit" të viteve

Shenim: Ky shkrim u botua te gazetata "Sporti shqiptar" dhe "Illyria" ne New York.

Gati çdo muaj mblidhen në veprimtari të ndryshme shqiptarët e Bostonit. Pas takimit në bashkinë e këtij qyteti ku u fol për traditat dhe kulturën shqiptare, festimit të 5 vjetorit të shoqatës " Kosova-Boston" , festivalit të zhvilluar në qytetin Uster, e kishte rradhën mbrëmja kushtuar sportistëve të shquar shqiptarë që jetojnë në Boston. Organizatorë të kësaj veprimtarie , ishin Federata "Vatra",Fondacioni "Frosina" si dhe Shoqata për të Drejtat e Njeriut " Çamëria". "Sofra" e këtij takimi , rreth të cilit u mblodhën pjesëmarrësit , ishte



Pjesmarres ne veprimtari

shtatëdhjet, Kujtim Kasmin, i cili qëndron në piedestalin e sportistëve shqiptarë. Skifteri e ngacmon atë të tregojë ndonjë nga momentet më të bukura të jetës së tij sportive. Dhe Kujtimi tregon për ndeshjen e paharruar me ekipin jugosllav në vitin 1965, e cila përfundoi me rezultatin 64 me 60 për ekipin jugosllav.



Skifter Kellici duke intervistuar Kujtim Kasmin

Ai kujtoi me respekt e mirënjohje, trajnerin e tij, të ndjerin Feti Borova, figurë e shquar e sportit shqiptar. Pyetjes tjetër të drejtuesit të veprimtarisë për basketbollin e sotëm në Shqipëri, ai ju përgjigj me modesti: "Ne nuk ishim më të mirë se basketbollistët e sotëm që luajnë në Shqipëri. Në kushtet e reja të krijuara, ata kanë mungesa, të cilat po të plotësohen, do të rrisin nivelin e basketbollit tonë", theksoi Kujtimi.

Një mbresë të veçantë tek të pranishmit, lanë edhe minutat kur u fol për voleybollistin e shquar, 35

vjeçarin Donald Suxho, i cili bën pjesë në ekipin olimpik amerikan. Ky ekip, ku ishte edhe Donaldi ynë, fitoi "Medaljen e artë" në Lojrat Olimpikë të Pekinit në vitin 2008. Në mungesë të Donaldit, pasi atë ditë ishte në Brazil për të zhvilluar një ndeshje me ekipin vendas të voleybollit, foli nëna e tij, Vera. Pasi tregoi pasionin e të birit dhe punën këmbëngulëse për të arritur deri këtu, ajo paraqiti fanellën e tij, ku kishin firmosur gjithë voleybollistët olimpikë amerikanë. Me arritjet e tij, duke njitur shkallët deri në ekipin olimpik, Donald Suxhua, i bën sot nder jo vetëm Shqipërisë por edhe Amerikës.



Bluza voleybollistit Donald Suxho

Në rradhën e paraqitjes së sportistëve të shquar shqiptarë që jetojnë në Boston, ka një gërshetim brezash. Te mikrofoni i Skifterit afrohet ish trajneri i voleybollit të ekipit të "Skënderbeut" të qytetit të Korçës, Pandi Gëllçi. Ka shumë për të treguar Pandi, pasi ka një jetë të tërë të lidhur me sportin. Ajo ze fill në qytetin e Pogradecit, ku ka drejtuar ekipin e djemve në vitet 1957-1962. Por, kariera e tij sportive, arrin lartësi të reja në qytetin e Korçës, ku ka qënë trajner i ekipit të voleybollit për femra, në vitet 1965-1991 dhe 2000-2001. Nën drejtimin e tij, ekipi korçar i femrave ka fituar katër herë titullin kampion dhe gjashtë herë kupën e Republikës. Rivali kryesor i këtij ekipi, ka qënë ai i "Dinamos", me trajner Kreshnik Tartarin, ekip i cili ka disa fitore më tepër në krahasim me "Skënderbeun". Skifteri fton pastaj në mikrofoni, ish voleybollisten e "Skënderbeut", Dhorka Koço, e cila ishte pjesë e asaj mbrëmje kushtuar sportistëve të shquar. - Themelet e ekipit korçar, i hodhi trajneri ynë Pandi Gëllçi, ndërsa në voleybollistet vumë nga një tullë në atë mur. Ekipi ynë ka patur shumë voleybolliste të shquara por "shtylla" e tij, ka qënë Tamara Nikolla, thotë Dhorka. Shenim: Ky shkrim u botua te gazetatat "Sporti shqiptar" dhe "Illyria" ne New York.

Një tjetër protagoniste e mbrëmjes festive kushtuar sportistëve të shquar që jetojnë në Boston , ishte e reja Maria Dhimi, e cila meret me sportin e xhudos dhe ka fituar disa medalje. Për talentin dhe perspektivën e saj , foli trajneri amerikan, Bill Stiven, që stërvit Marien. Duhet theksuar se këtë sport ,nuk e mbështet shteti amerikan dhe shpenzimet e saj i përballon vetë familja.

Komentatori Këlliçi fton pastaj në mikrofon Anila Began , 13 here kampion në Shqipëri në hedhjen e diskut. Rekordet e saj , ende nuk i ka thyer ndonjë vajzë tjetër në Shqipëri. Anila jeton në Amerikë , së bashku me bashkëshortin e saj , çiklistin e njohur Agron Bega, ish trajner i ekipit kombëtar të të rinjve. Personazhe të asaj mbrëmje të bukur, ishin edhe sportistë të tjerë si: Gilman Lopçi, kampion i vrapimit në 100 m ; Edvin Angjeli, i cili ka thyer pesë rekorde në Shqipëri dhe është notari më i mirë në Amerikë për moshën e vet ; Elvir Musaliu nga Kosova, sportist i shquar në karate, i cili ka zënë vëndin e parë në Kosovë dhe ka marrë disa vlerësime këtu në Amerikë; Amilda Isufaj, notare e shquar, rekordmene e ekipit të “Flamurtarit”; Agron Balluku, ish futbollisti i njohur i “Partizanit” , etj. Në mungesë, u kujtuan në atë mbrëmje edhe sportistë të tjerë që jetojnë në Boston si Aleksandër Dheri , basketbollist i shquar , pjesëtar i ekipit të “Partizanit” , shtatë herë kampion në vitet shtatëdhjet; Petrika Suxho, volejbollist i njohur i ekipit të “Skënderbeut” si dhe Agron Bega, çiklist, ish trajner i ekipit kombëtar të të rinjve në këtë sport.



Nje kujtim pas veprimtarise
(Anila Bega dhe Amilda Isufaj)

Nuk mungoi pa folur edhe në këtë takim shqiptarësh në Boston , poetja dhe shkrimtarja e njohur, Rozi Theohari. Duke gërmuar nëpër biblioteka dhe arkiva amerikane, ajo gjen diçka shqiptare .Këtë radhë ajo kish sjellë një informacion të panjohur më parë për për shqiptarin , Anastas Strugis, me origjinë nga Korça, maratonis i shquar në Amerikë,në fillimet e shekullit të kaluar. Ai kish marrë pjesë edhe në përrurimin e kishës së Nolit në Boston.

Minutat e fundit të takimit, komentatori Skifter Këlliçi , ja kushtoi futbollistit të shquar Medin Zhega, i cili gjithashtu jeton në Boston. Zhega nuk ishte i pranishëm në sallë pasi ka qënë në gjëndje tërëndë shqndetësore por ditët e fundit ka patur përmirësime. Për jetën e tij sportive , foli Skifteri, i cili ftoi pjesëmarrësit të duartrokisnin për shërimin e shpejtë të tij. Duartrokitjet e gjata për futbollistin e shquar , Medin Zhega, ishin si të thuash epilogu i asaj mbrëmje të bukur, e cila u filmua(dhe trasmetua) nga Arben Kamberi, përgjegjës i një stacioni televiziv shqiptar në qytetin e Usterit.

Ja , kështu kaluan pa u ndier mbi dy orë me sportistët e shquar shqiptarë që jetojnë në Boston e qytetet rreth tij. Ishte kjo një mirënjohje për ata që kanë lënë gjurmë të pashlyera në sportin shqiptar si dhe për ata sportistë të rinj, që vazhdojnë të lenë gjurmë në ditët e sotme.

Qershor, 2011

Shenim: Ky shkrim u botua te gazetata “Sporti shqiptar” dhe “Illyria” ne New York.